

Raport vjetor

Aktivitetet e BSPK
për vitin 2016

Prishtinë me 20 dhjetor 2016

Nga: Dafina Mehaj

Përmbatja

Hyrje	3
Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të BSPK	4
Mbledhjet e Kryesive të BSPK-së	5
Mbledhjet e KES	7
Aktivitetet Ndërkombëtare	12
Aktivitetet e Rrjetit të Gruas	16

Shkurtesat

AKP	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
QPA	Qendra për Politika dhe Avokim
ETUC	European Trade Union Confederation Konfederata e Sindikatave Evropiane
ITUC	International Trade Union Confederation Konfederata e Sindikatave Ndërkombëtare
ILO	International Labour Organization Organizata Ndërkombëtare e Punës
PERC	Pan European Regional Council Këshilli Pan Evropian Sindikal
KES	Këshilli Ekonomiko Social
KD	Këshilli Drejtues
PEN	Peer Educators Network

Hyrje

Gjatë vitit 2016 BSPK-ja mbajti Këshillin Drejtues në muajin tetor, u mbajtën edhe tetë mbledhje të Kryesive Ekzekutive si dhe takime të rregullta të KES. Takimi i nëntë i KE do të mbahet në fund të muajit dhjetor 2016.

Në aktivitetet ndërkombëtare, në të shumtën e rasteve BSPK është përfaqësuar nga kryetari i saj, z. Haxhi Arifi, së bashku me nënkryetarët dhe zyrtarët tjerë sindikal. Rrjeti rinor dhe i gruas gjithashtu kanë qenë aktiv mirëpo shumë shpesh kanë hasur në pengesa për të marrë pjesë në këto aktivitete për shkak të mos liberalizimit të vizave në Republikën e Kosovës. Megjithatë BSPK-ja ka qenë prezente në shumë takime të niveleve të larta në rajon, Evropë dhe më gjerë.

Këshilli Drejtues i BSPK

U mbajt në Prishtinë me 05.10.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar e Kshillit Drejtues 24.12.2016;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës dhe atij financiar të BSPK-së;
- Vendimi për datën e propozuar nga Kryesia Ekzekutive e BSPK-së për mbajtjen e Kongresit të VII-të të BSPK-së me datën 04.11.2016;
- Të ndryshme.

Vendimet të cilat u morën në KD janë:

- Vendim mbi miratimin e Raportit Financiar për vitin 2012-2015;
- Vendim mbi miratimin e raportit të punës së BSPK-ës për vitin 2011- 2016;
- Vendim për prolongimin e kërkesës së Federatës së Shërbyesve Civil të Republikës së Kosovës për anëtarë në BSPK;
- Kongresi i VII-të i BSPK-së të prolongohet deri në pranverën e vitit 2017.

Kryesitë Ekzekutive të BSPK

1. Mbledhja e parë e KE u mbajt me 26.01.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit nga mbledhja e datës 10.09.2015;
- Strategjia e BSPK për periudhën 2016-2026;
(u morr vendim që të krijohet një grup punues për të përpiluar këtë strategji)
- Informatë për Auditimin e Jashtëm të BSPK;
- Të ndryshme.

Vendimet:

- Obligohen Degët e BSPK të mbajnë zgjedhjet para kongresit;
- Afati i ndryshimeve statutare në afatin prej 30 ditësh, në mënyrë që komisioni të mund të punojë.
- Zgjedhja e komisionit për verifikimin e kandidaturave, (Ryzhdi Bloku, Rashit Mehmet, Muharrem Gashi).

2. Mbledhja e dytë e KE u mbajt me 04.03.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të KE nga mbledhja e kaluar;
- Informatë nga punëtorja e Rrjetit të Gruas nga Projekti me ILO;
- Informatë nga takimet e KES, e mbajtur me 01.03.2016;
- Shqyrtimi për propozimet për caktimin e datës së mbajtjes së Kongresit të VII-të,
- Të ndryshme.
 - Bordi i AKP-së;
 - Delegacioni përmanifestimin e 25 vjetorit të BSPK të themelimit të BSPK;
 - Informatë për botimin e librit të Mehmet Akifit (5000 ekzemplar);
 - Informatë për takimin me SBASHK.

3. Mbledhja e tretë e KE u mbajt me 13.04.2016 me këtë rend të ditës:

- Miratimi i ekstraktit i datës 04.03.2016;
- Informatë nga takimi i KES;
- Informatë nga takimi i Komitetit Ekzekutiv të PERC/ETUC;
- Një Maji Dita e Punëtorve;
- Të ndryshme.

4. Mbledhja e katërt e KE u mbajt me 27.05.2016 me këtë rend të ditës:

- Miratimi i ekstraktit të KE të datës 13.04.2016;
- Informatë nga takimi me ILO mbajtur me datat 26-28 prill 2016;
- Informatë nga takimi me KES i mbajtur me datat 04.05.2016-24.05.2016;
- Informatë nga punëtorja me ILO e mbajtur me datën 05.06.2016
- Të ndryshme.

5. Mbledhja e pestë e KE u mbajt me 09.06.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
- Situata e përgjithshme në BSPK.

6. Mbledhja e gjashtë e KE u mbajt me 27.07.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
- Shqyrtimi i Memorandumit të 30 qershorit 2016, (nga Grigor Gradev);
- Informatë nga takimi i KES;
- Zhvillimi i Aktiviteteve të BSPK në mes të dy mbledhjeve të kryesisë ekzekutive
- Të ndryshme.

7. Mbledhja e shtatë e KE u mbajt me 30.09.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar e mbajtur me 27.07.2016;
- Informatë nga takimet e KES të mbajtura me 21.09.2016;
- Informatë nga zhvillimi i aktivitetit vendor dhe ndërkombëtar të BSPK;
- Të ndryshme.

8. Mbledhja e tetë e KE u mbajt me 11.11.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
- Informatë nga aktivitetet e BSPK, në mes të dy takimeve;
- Të ndryshme

Mbledhjet e KES

1. Mbledhja e pare u mbajt me 01.02.201 me këtë rend të ditës:

- Regjistrimi i pjesëmarrësve;
- Aprovimi i rendit të ditës;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
- Raporti një vjeçar i punës së KES, diskutime;
- Kalimi i mandatit të kryesuesit të KES, tek organizatat e punëdhënësve;
- Të ndryshme.

2. Mbledhja e dytë e KES u mbajt me 01.3.2016 me këtë rend të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës;
- Formimi i Komisionit për interpretim të Marrëveshjes Kolektive;
- Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja e fundit;
- Të ndryshme.

3. Mbledhja e tretë e KES u mbajt me 19.03.2016 në Tiranë, me këtë rend të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
- Raporti përfundimtar i kualifikimit të profesioneve ISCO-08;
- Raporti nga plani Strategjik;
- Të ndryshme

4. Mbledhja e katërt e KES u mbajt me 04.05.2016 me këtë rend të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës;
- Diskutimi për Ligjin Shëndetësor Nr. 04/L-249;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;

5. Mbledhja e pestë e KES u mbajt me 24.05.2016 me këtë rend të ditës:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të KES, nga mbledhja e kaluar;
- Diskutimi për pjesëmarrjen në Konferencën e ILO;
- Ligji i Punës;
- Ligji i KES-it.

6. Mbledhja e gjashtë e KES u mbajt me 20.07.2016 me këtë rend të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës;
- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KES nga mbledhja e kaluar;
- Raport nga vizita në Konferencën e ILO në Gjenevë;
- Kalimi i mandatit të Kryesuesit të KES tek përfaqësuesit e punëdhënësve;
- Të ndryshme.

7. Mbledhja e shtatë e KES u mbajt me 21.09.2016 me këtë rend të ditës:

- Regjistrimi i pjesëmarrësve;
- Aprovimi i rendit të ditës;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
- Raport nga vizita studimore në Austri;
- Kalimi i mandatit të Kryesuesit të Këshillit Ekonomiko Social, tek organizatat e punëdhënësve;

8. Mbledhja e tetë e KES u mbajt me 11.11.2016 me këtë rend të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e fundit e KES;
- Raport për seminarin ndër regjional nga ILO i mbajtur në Beqir të Malit të Zi;
- Paga minimale (e cila nuk u shqyrtua fare në mungesë të ministrit të MPMS);
- Të ndryshme.

9. Mbledhja e nëntë e KES u mbajt me 12.12.2016 me këtë rend të ditës:

- Aprovimi i rendit të ditës;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e fundit e KES;
- Informim mbi Ligjin e KES;
- Prezentime nga ana e partnerëve social për projekt- propozimet e dorëzuara në ministri;
- Të ndryshme.

KES mbledhje e mbajtur në Beçiq të Malit të Zi

Qëllimi i kësaj vizite ka qenë pjesëmarrja në seminarin ndër regional të organizuar nga ILO-ja, i financuar nga Bashkimi Evropian me temën: “Rishikimi i funksionimit të Këshillave Ekonomiko-Social” në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, siq janë: Kosova Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia.

Si fillim seminari është hapur nga Ministri i Malit të Zi z.Boris Mariç, duke vazhduar me prezantimet e përgatitura nga përfaqësuesit e ILO-së: Antonio Graziosi, Kiril Kiryakov, Susanne Nielsen, Kristina Mihes, të cilët përpos rolit dhe rëndësisë së Dialogut social na njoftuan edhe me qëllimin e seminarit. Qëllimi kryesor i këtij seminari është ri-shikimi i funksionimit të Këshillave Ekonomiko-social, ku nga tri shtete të ndara në grupe, dy shtete do të vizitohen shtetin e tretë dhe do të shohin për së afërmi funksionimin atje dhe pastaj do ta kenë mundësinë të paraqesin një raport dhe disa rekomandime se çka mund të përmirësohet, për një funksionim më të mirë.

Lidhur me funksionimin, të arriturat dhe problemet që paraqiten në Këshillin e Malit të Zi, folen znj. Suzana Raduloviç-në emër të punëdhënësve, pastaj Srxha Kekoviç-në emër të punëmarrësve dhe Vladimir Curoviç-përfaqësues i ILO-së.

Pjesëmarrësit :

- Haxhi Arifi – Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK);
- Alush Sejdiu - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK);
- Fatmir Haxholli – Këshilltar i Ministrit të MPMS-së;
- Parim Bajrami – Oda Ekonomike e Kosovës (OEK);
- Agim Shahini – Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB);
- Fatime Rexhepi – Shefe e Sekretariatit Koordinues të KES-it, MPMS

Objektivi :

Si objektivi kryesor gjatë seminarit përfaqësuesit e ILO-së kanë paraqitur termat e referencës, përmes të cilave shtetet pjesëmarrëse do të paraqesin raportet e funksionimit të Këshillave Ekonomiko-Social në vendet e tyre. Pastaj shtetet e ndara në grupe kanë analizuar këto terma dhe i kanë paraqitur vërejtjet dhe propozimet e tyre se çka duhet të ndryshohet apo të shtohet. Gjatë kësaj pune Kosova ka qenë në grup me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Të arriturat:

Gjatë këtij seminari është paraqitur një mundësi e mirë për përmirësimin e funksionimit dhe fuqizimit të Këshillit Ekonomiko-Social, përmes rekomandimeve që do të bëhen në vazhdim të këtij seminari, duke marrë përvojat më të mira të shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe të shteteve të BE-së.

Rekomandimet:

Si rekomandim në fund të seminarit ka qenë caktimi i grupeve të shteteve të cilat do të vizitohen gjatë muajve në vijim si dhe caktimi i datave të këtyre takimeve. Kosova është caktuar në grup me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Gjithashtu është rekomanduar që shtetet të ndahen në dy grupe: grupi A, në rastin konkret Kosova do të vizitohet Maqedoninë dhe grupi B që do të vizitohet Shqipërinë. Të dy grupet do të përbehen prej katër anëtarëve: një përfaqësues nga punëdhënësit, një nga punëmarrësit, një nga Qeveria si dhe udhëheqësi i Sekretariatit. Kjo ndarje në dy grupe është bërë për arsye se në shumicën e shteteve në KES përfaqësohen dy organizata të punëdhënësve apo punëmarrësve, prandaj të kenë mundësi të dyja të jenë pjesë e këtij seminari. Si rekomandim përfundimtar ka qenë se anëtarët e këtyre grupeve duhet të jenë anëtar të Këshillit Ekonomiko-Social dhe Këshilli duhet ti caktojë përfaqësuesit e vetë në të dy grupet.

KES mbledhje e mbajtur në Vjenë, Austri

Me organizimin dhe sponsorizimin e Organizatës “Përkrahje Partnerëve Social” (IKS), prej datës 26-29.06.2016, përfaqësuesit e KES-it bënë një vizitë studimore në qytetin e Vjenës, Austri.

Përbërja e përfaqësuesëve të KES-it për vizitë studimore në Wien ishte: dy përfaqësues nga bizneset, dy përfaqësues nga sindikatat, përfaqësues nga MPMS dhe zyrtarë të IKS.

Takimet e ditës së parë

Me 27.06.2016, takim me Ambasadorin e Republikës së Kosovës dhe stafin e tij në selinë e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Vjenë. Takimi ishte shumë konstruktiv dhe i ngrohtë, Ambasadori na informoi për punën, sfidat dhe shërbimet që ofrohen nga Ambasada sidomos për bashkëatëdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në Austri. Po atë ditë u takuam edhe me përfaqësuesit e katër partnerëve social në selinë e Odës Ekonomike të Austrisë. Nga nikoqirët u informuam detalisht për punën dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Social në Austri si: përbërjen e Këshillit, (katër partner), strukturën organizative, çështjet të cilat i shqyrtojnë, numrin e anëtarëve (3.2 milion), afati i zgjedhje në Këshill (5 vjet), financimi (i rregulluar me ligj, 0,5% e pagës minimale rreth 450€), 97% e punëtorëve të paisur me Kontrata Pune. Takim i tretë u realizua me përfaqësues të Odës së Punëtorëve, ku u informuam për punën dhe çështjet që debatohen me partnerët social.

Takimet e ditës së dytë

Takim me deputetin z. Karl Ollinger në zyrën e tij, në selinë e Parlamentit të Austrisë. Nga deputeti u informuam për mënyrën e inicimit të çështjeve në Parlament nga ana e partnerëve social. Takim tjetër ishte me përfaqësues të Institutit Austriak për Hulumtime Ekonomike. Takimi ishte shumë interesant, nga Prof. Dr. Martin Stoika- zv/President i Institutit, u njoftuam për rolin dhe punën e Institutit. Ky Institut është më i madhi në Austri, nuk është pjesë e Qeverisë është privat me 100 të punësuar, kryesisht hulumtues. Instituti ishte themeluar në vitin 1927 nga Ludwig Mises dhe August Fayek. Instituti ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë

Univerzitete në vend dhe jashtë vendit, analizat i bëjnë të pavarura dhe ia prezantojnë BE. Për 10 vite analizat ekonomike të Institutit të cilat ia paraqesin Qeverisë e kjo ia paraqet BE, BE dëshiron që këto politika të aplikohen edhe në shtetet tjera. Është i lidhur me rrjetet hulumtuese, hulumtimet bëhen urë lidhëse mes teorisë dhe praktikës, punojnë shumë me të dhënat empirike. Në fillim të vitit 2016, kanë dorëzuar një projekt të madh hulumtues në Qeveri. Të gjitha hulumtimet e Institutit evidentohen në Revistën Akademike Shkencore.

Struktura e Financimit të Institutit

- 33% Subvencione,
- 60% Qeveria Qëndrore,
- 7% Partnerët Social

Studimet

- Nga fusha Makro-Ekonomike në vendë dhe në Evrop,
- Në fushën e hulumtimit,
- Tregun e Punës, Ekonomisë,
- Çështjet sociale , të ardhurat, reformat ekonomike etj.

Partnerët Social ndikojnë në financimin e Institutit, Instituti bashkëpunon me këta Partner Social:

- Oda Ekonomike e Punëdhënësve,
- Odat e Bujqësisë,
- Odën e Punëtorëve dhe
- Federatën Sindikale të Austrisë.

Nuk ka bazë ligjore për bashkëpunim me këta partner, bashkëpunimi bëhet vullnetarisht.

Detyrat

- Marrëveshjet Kolektive për pagat,
- Arsimimi dual,
- Përshtatja e politikave në ligje , drejtësi, ekonomi, ligjet të cilat draftohen nga Qeveria sillen tek partnerët sociël të cilët i dhënë vërtetjet dhe propozimet e tyre.
- Instituti është pjesë e Kumunitetit Ekonomiko-Social Evropian

Takimet e ditës së tretë

U takuam me përfaqësues nga Instituti Hayek, Dr, znj. Barbara Kolen –Kryetare e Institutit, na informoi për punën e Institutit. Instituti është themeluar në vitin 1992 nga Fridrih August. Studimet Instituti i bënë rreth TVSH-ës, Partnerëve Social,Ekonomisë Sitemit Pensionsal etj., ishte interesant se modeli i sitemit të tyre pensionsal aplikohet aktualisht në 35 vende të Botës.

Studimi kryesor i Institutit është Analizat e Zhvillimit Ekonomik. Partnerët Social

Për 20 vite janë pjesë e Sindikatës, kanë biznese private, pozitën e tanishme të funksionimit të Partneritetit Social e sheh në aspektin mjaft kritik. Znj. Barbara është anëtare e një grupi punues e caktuar nga BE-ja, për hartimin e një plani për Zhvillimin Ekonomik të Kosovës.

Konsiderojmë se kjo vizitë ishte tepër e rëndësishme, ku patëm rastin të njihemi me praktika edhe eksperiencia të reja. Këto përvaolja duhet të angazhohemi t'i inkorporojmë në politikat tona, nëse kjo arrihet efektet do të jenë mjaft pozitive.

Aktivitetet Ndërkombëtare

Punëtorja: "Garantimi i së ardhmës për sindikalistët e rinjë"

Kjo punëtorja zgjati prej datës 29 janar deri me datën 1 shkurt 2016 në Ohër të Maqedonisë. Tema ishte "Garantimi i së ardhmës për sindikalistët e rinjë". Rrjeti i të Rinjëve i BSPK u përfaqësua nga Znj. Arta Sejdiu dhe Znj. Violeta Alidema. Në këtë punëtorje morën pjesë sindikalistët të rinjë nga i gjithë rajoni.

Punëtorja: "Barazia gjinore në negocijimin kolektiv"

Nga data 18 Shkurt deri me datën 19 Shkurt 2016 në Prishtinë u zhvilluan punimet e punëtorisë me temën: "Barazia gjinore në negocijimin kolektiv. Pjesëmarrëse ishin aktiviste të ndryshme nga federatat sindikale të BSPK. Poashtu në këtë punëtorje pjesëmarrës ishin edhe Znj. Olga Nicolae përfaqësuese e zyrës së ITUC/PERC në Bruksel, si dhe Z. Grigor Gradev përfaqësues i ILO në Budapest si dhe Znj. Lindita Boshtrakaj zyra e ILO në Prishtinë. Ligjëruese për pjesëmarrësit në këtë punëtorje ishte profesoresha Agnieszka Giniraru.

Punëtorja e organizuar në mes të ILO/ITUC/BSPK

Në muajin gusht BSPK e vizituan z. Jaap Wienen, zëvendës sekretar i përgjithshëm i ITUC dhe z. Grigor Gradev përfaqësues i ILO në Budapest.

Gjatë rrugëtimit të vet, dihet se BSPK-ja ka pas, ka dhe do të ketë sfida, andaj kjo e obligon për një qasje serioze, të urtë dhe profesionale në ballafaqim me çështjet dhe pengesat që i dalin gjatë kohës.

Propozimet e ITUC/ILO

- Bazuar në rolin dhe përgjegjësitë që ka BSPK-ja si Konfederatë e vetme në vend, do të punoj fuqishëm që edhe në të ardhmen të jetë kështu, duke ju ofruar të gjitha Shoqatave, Degëve sindikale kushte që përmes dialogut të kenë përfaqësim dhe gjithnjë të jenë pjesë e BSPK-ës, por do të kërkoj që parimet, kriteret dhe praktikrat që bashkarisht i kemi instaluar të respektohen nga të gjithë.
- Në këtë kontekst, propozimet e ITUC/ILO bazuar në principet dhe parimet e sindikatave ndërkombëtare dhe evropiane pjesë e të cilave jemi edhe ne, BSPK-ë i ka pranuar dhe në bazën e tyre me ndihmën e edhe të vllëzërve sindikal ndërkombëtar përfaqësues të këtyre sindikatave, ka hartuar aktet normative të veta në baz të të cilave vepron.
- BSPK-ë, ka zhvilluar këtë do ta bëjë edhe në ardhmën takime të shumta me Shoqata dhe Degë sindikale që aktualisht nuk janë pjesë e saj me prezencë edhe të ndërkombëtarëve, më qëllim të përafritit, kjo mendojmë se duhet të vlerësohet, e jo të etiketohet BSPK-ja si penguesë e reformave në baz të opinionëve dhe të dhënave të momentit, nga njerëz jo kompetent të cilët i demostrojnë edhe raportin e Auditorit.

- BSPK-ë, deri me tani nuk ka asnjë propozim, kusht apo kriter konkret nga asnjë Shoqatë apo Degë që njëanshëm kanë ndërprer bashkëpunimin me BSPK-ën. Andaj BSPK-ë nuk guxon dhe nuk mundë të bie pre e shantazheve, dezinformative, gjysëm të vërtetave dhe interesave të momentit që flasin në emër të BSPK-ës të pa autorizuar, të gjitha shqetësimet, dyshimet eventualish lavdat mund dhe duhet të zhvillohen në selinë dhe strukturat e BSPK-ës, gjithëmon ka vend për përmirësime dhe dialog për këtë jemi të hapur dhe të gatshëm gjithmonë.
- BSPK-ë, nuk mundë ta vej në pikëpyetje veprimtarin e vet 26 vjeçare për interesa të momentit, duke pas parasysh se numri i anëtarëve sindikal është relativ dhe ndryshon çdo herë rrjedhimisht ndryshon edhe fuqia e shoqatave dhe degëve sindikale, andaj duhet të veprojme në baz të rregullave të cilat i kemi krijuar vet e jo të krijujmë presedane.
- Pritjet janë që sektori privat të fuqizohet shumë me anëtarësi sindikale, sepse në këtë sektor janë të punësuar mbi 300 mijë veta, andaj të gjithë duhet t'iu nënshtrohemi rregullave, për të qenë funksional dhe të sukseshëm në mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë.

Korniza

Sigurisht që Komisioni për përgatitjen e Kongresit, do ta bëjë një korniz apo agjendë të veprimit, e njeta do ti prezantohet organit më të lartë të BSPK-ës pas Kongresit, Këshillit Drejtues i cili do ta aprovoj.

Ngritja e Komisionit Përgaditor

BSPK-ë ka pranuar propozimin e ITUC/ILO, për nominim e anëtarëve të komisionit, të nesërmen pas mbajtjes së takimit, ka dërguar emrat e 5 anëtarëve të Komisionit përgaditor, kjo nuk ka ndodh nga ana e Degëve të Shëndetësisë, Arsimit dhe Policisë.

Pastaj na erdhi Memorandumi i Z Grigor Gradev, ku këshillohemi që një nga anëtarët e komisionit përgaditor të jetë femër dhe komisioni të ketë nga 3 anëtar nga të dyja palët (në rastin e BSPK-ës + Presidenti), ndarja në pal nuk është korrekte. BSPK-ë do ta pranohet edhe këtë këshillë.

Draft Agjenda dhe hapat e mëtutjeshëm:

Komisioni në agjendën e vet të veprimet, procedurat dhe aktivitetet tjera do ti përcaktoj konform Statutit dhe akteve tjera të BSPK-ës dhe të propozoj dikë që edhe njëherë të verifikoj numrin e anëtarësisë së degëve, në mënyrë që askush mos ta ndiej vetën të dëmtuar për përfaqësim në Kongres.

Skemën (tabelën) e propozuar nga ITUC/ILO, për formën e caktimit të numrit të delegatëve për Kongres, BSPK-ë e pranohet në tërësi. Po ashtu pranohet forma e Pragut të shumicës së thjeshtë dhe Shumicës së cilësuar.

Nëse këto kritere aprovohen në Kongres, sigurisht që kjo formul do të aplikohet për të gjitha degët në përbërjen e Strukturave të BSPK-ës.

Hapat e mëtutjeshëm

- Komisioni përgaditë një propozim në përputhje me qasjen e dakorduar, BSPK-ja e aprovon në Këshillin Drejtues, si bazë për përgatitjen e Kongresit.

- Komisioni vazhdon me përgaditjen e dokumenteve të Kongresit (Statutin, Programin, Rezolutat etj) të cilat do të ofrohen Kongresit për aprovim, me këtë edhe përfundon puna e Komisionit për Përgaditjen e Kongresit.
- Komisioni nuk mundë të dal me propozime si: Kush do të jetë Kryetar i BSPS, apo kryetar i KD, kush do të jetë anëtarë i KES-it, përfaqësimi jashtë etj. Të gjitha këto rregullohen me Statut dhe akte tjera të BSPK-ës, të njejtat qitën për aprovim në Kongres, pas aproimit të gjitha Organet dhe Strukturat e BSPK-ës marrin të drejtat dhe obligimet e plota për mandatin vijues.

BSPK, do të angazhohet fuqishëm për krijimin e një klime të favorshme për të gjitha shoqatat dhe degët sindikale jo vetëm të tri degëve, për një gjithëpërfshirje sa më të madhe, për reforma, për fuqizimin sa më të shpejt të Rrjetit të Rinjëve dhe Rrjetit të Gruas. Jemi të bindur se për këtë do ta kemi përkrahjen e plotë të ITUC, ETUC, ILO etj.

Takim rajonal PERC/ ILO u mbajt me 05- 07 tetor 2016, në Tiranë, Shqipëri

Pjesëmarrësit që ishin prezent në këtë takim ishin nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Bosnia e Hercegovina, Kroacia dhe Republika Serbe. Moderatore ishte Zj. Enisa Salimovic, koordinatorë e PERC në Sarajevë. Prezentues ishin: Viktor Kampa, Karoly Gyorgy, Cornelou Constantinoai, të cilët folën për sukseset dhe gabimet të shteteve të tyre (Rumani, Hungari dhe Poloni)

Tema kryesore : “Rrjetëzimi Sindikal në fushën e Mbrojtjes dhe Shëndetit në Punë” me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.

Qëllimi i mbledhjes ishte:

1. Forcimi i kapaciteteve sindikale në lëmin e Sigurimit dhe Shëndetit në Punë;
2. Forcimi të kapaciteteve sindikale për ndërtimin e sistemit të pavarur të Mbrojtjes dhe Sigurisë në punë;
3. Informacionet e duhura;
4. Shkëmbimi i përvojave dhe mundësive strategjike.

U vendos që të krijohet një strategji të përbashkët për Shtetet e Ballkanit, gjegjësisht krijimin e rrjetit të qëndrueshëm Ballkanik të PERC për Mbrojtje dhe Siguri në Punë.

Seminari i mbajtur në Parlamentin Evropian

Me datën 9 nëntor 2016 në Bruksel u zhvilluan punimet e seminarit me temën "Fokusimi në gjendjen socio-ekonomike në regjionin e Ballkanit Perëndimor". Ky seminar u organizua nga Grupi Parlamentar i Social-Demokratëve të Parlamentit Evropian në bashkëpunim me ETUC. Pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e sindikatave nga këto vende, parlamentarët e lartpërmendur si dhe përfaqësuesit e ETUC. Në pjesën e dytë të këtij seminari, pjesëmarrësit patën rastin të marrin

pjesë në prezentimin e komisionerit Johannes Hahn në komitetin e AFET. BSPK në këtë seminar u përfaqësua nga kryetari Haxhi Arifi, fjalimin e tij të plot mund ta gjeni në webfaqen e BSPK.

Simpoziumi Internacional i Bashkimit të Sindikatave të Punëtorëve Islamik

Me ftesë të Konfederatës Turke MEMUR-SEN prej datës 12-17 tetor 2016 në Stamboll, BSPK morri pjesë në Simpoziumin Internacional të Punëtorëve Botërorë Islamik. Në Simpoziuum ishin prezentë përfaqësues sindikal nga 55 shtete të Botës. Në këtë Simpoziuum BSPK u përfaqësua nga Haxhi Arifi kryetar dhe nga Alush Sejdiu nën kryetar i BSPK.

Qëllimet e këtij Simpoziumi ishin: bashkëpunimi reciprok, shkëmbimi i përvojave, organizimi i takimeve nepër vende të ndryshme me qëllim të ndihmës reciproke për luftimin e padrejtësive që u bëhen punëtorëve. Punimet e Simpoziuumit u zhvilluan të ndara në tri grupe në tri gjuhë dhe zgjatën dy ditë. Me këtë rast u zhvilluan shumë takime me përfaqësues sindikal të shumë shteteve të botës. Në të ardhmen do të zhvillojmë bashkëpunim substancial me këto shtete me qëllim të shkëmbimit reciprok të përvojave, organizimit të takimeve nepër vende përkatëse, shkëmbimi i informative etj. Në fund të Simpoziuumit, u nënshkrua Deklarata e Stambollit (Marrveshje Bashkëpunimi) nga përfaqësues të të gjithë pjesëmarrësve, ku specifikohen format e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke.

Vizitë studimore e delegacionit të Kosovës në Lituani, 08-09 dhjetor 2016

Ky aktivitet u zhvillua në Agjensionin e Statistikave të Lituaniës / Ministria e Ekonomisë e Republikës së Lituaniës / Shërbyesit Publik Punësimi (PES), Lituani. Përfaqësues i BSPK në këtë takim ishte z. Alush Sejdiu i cili e përfaqëson BSPK në të gjitha aktivitetet e projektit Klasifikimi i Profesioneve.

Temat e diskutuara ishin: fushëveprimi i punës së Agjensionit të Statistikave Lituaneze, bashkëpunim me autoritetet lokale, Eurostat dhe ONA. Përgjegjësia kryesore: koordinimi i statistikave. Baza Ligjore: zbatimi konsekuent i klasifikimeve në Lituani është e rregulluar me Rezolutën Nr 247 e 3 Mars 2005. Në këtë çështje, statistikave lituaneze janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe siguruar ato për publikun dhe institucionet tjera.

Klasifikimet , sigurimi i informacioneve në mënyrë për të shpejt dhe në mënyrë të njëtrajtshme për partnerët ndëkombëtarë dhe gjithashtu për të përdorur informacionin e tyre për krahasim.



Alush Sejdiu, i cili e ka përfaqësuar BSPK në këtë vizitë studimore konsideron se kjo vizitë ishte shumë e rëndësishme për ne, ku u fitua përvoja e re, sidomos për klasifikimet e profesioneve ku edhe Kosova është në proces të klasifikimit të profesioneve, si një faktor kryesor në fushën e arsimit në Kosovë dhe një standad për anëtarësim të Kosovës në BE.

Aktiviteti i dytë i Projektit HAK-IS, BSPSH dhe BSPK

Në kuadër të projektit të “Zhvillimi i Kapaciteteve të Sindikatave të Turqisë, Kosovës dhe Shqipërisë” u mbajt takimi i dytë me radhë në Tiranë, me datat 15-16 dhjetor 2016. U fol për sfidat dhe strategjitë e sindikatave me theks të veçantë u fol për emigracionin e cila është temë kyqe e në situatën e tanishme, ku po preken punëtorët e tërë botës.

“Turqia është nikoqire e miliona refugjatëve sirianë dhe kjo situatë i ka sfidat e veta”, si do të jetë qëndrimi i këtyre refugjatëve në Turqi? A do të punësohen, trajnohen, shkollohen ata?? Si dhe cilat janë sfidat e sindikatave turke në këtë situatë, tha mes tjerash në fjalimin e tij z. Mahmut Arslan, kryetar i HAK-IS.

Pjesëmarrës nga Kosova në këtë aktivitet ishin: Alush Sejdiu, nënkryetar i BSPK, Dafina Mehaj, Zyrtare për Marrëdhënie Ndërkombëtare si dhe Jusuf Azemi kryetar i SPEVZ. Në fjalimin e tij, z. Sejdiu mes tjerash ceku se: *“ne Kosovarët e dime shumë mirë qka dmth të jesh refugjat sepse në më pak se dy dekada kemi qenë në një situatë të tillë. Ndhmën të cilën ia ka dhënë Shqipëria Kosovës gjatë luftës dihet dhe skemi qka shtojmë, por e falendërojmë edhe Turqinë e cila pos shumë ndihmave humanitare ka qenë edhe një ndër shtetet e para e cila e ka njohur Republikën e Kosovës si shtet i pavarur”* tha Alush Sejdiu.

Aktiviteti i tretë i këtij projekti do të mbahet në fillim të vitit 2017 në Kosovë, ku për datat e sakta dhe temat e takimit do të vendoset në njërin nga KE e BSPK gjatë vitit të ardhshëm.

Aktivitetet e Rrjetit të Gruas

Tryezë e mbajtur me 06 dhjetor, në Prishtinë, Qendra e Konferencave, Orion

Në kuadër të projektit ‘Fuqizimi i Sundimit të Ligjit-Promovimi i të Drejtave të Punëtorëve’ përkrahur nga Olof Palme International Center (OPIC), Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) ka prezantuar një hulumtim lidhur me shkëljet e ligjit të punës. Në tryezë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të disa sindikatave të Kosovës, u theksua se të gjeturat kryesore të hulumtimit janë që shumica e punëtorëve punojnë pa kontrata pune ose me kontrata me afat të kufizuar, ka problem me largimin e punëtorëve nga puna, sigurinë në vendin e punës, moskompensimin e orëve shtesë, pushimin vjetor, mjekësor dhe atë të lehonisë.

Sa i përket të punësuarve me kontrata pune del se vetëm 29.2% e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 70.8% kanë kontratë të përkohshme. Megjithë këto masa të ndërmarra nga institucionet për zbatimin e ligjit, numri i punëtorëve të cilët kanë gjetur vdekjen në vendin e punës dhe të atyre që kanë pësuar lëndime të rënda trupore mbetet shqetësues. Sipas raportit të Inspektoratit të Punës për muajt Janar-Shtator 2016 dhe të dhënave të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), 33 të punësuar

kanë pësuar lëndime të rënda, ndërsa 6 kanë pësuar me fatalitet. Sipas përfaqësueses së BSPK-së, Dafina Mehaj, numri i rasteve që kanë pësuar lëndime në punë është shumë herë më i madh, mirëpo punëtorët nuk i raportojnë ato nga frika se të njëjtit mund të largohen nga puna.

Përfaqësuesi i SBASHK-ut, Rrahman Jashari u shpreh se gjendja e punëtorëve të arsimit është relativisht e mirë, ku si përparësi përmendi kontratat e punës që fillimisht janë njëvjeçare e pastaj bëhen të përhershme. Nga ana tjetër përfaqësuesja e Sindikatës së Policisë së Kosovës, Valbona Kamberi theksoi se problem mbeten pagat e ulta për punonjësit policor duke pasur parasysh rrezikshmërinë e punës së tyre, mungesën e pensionit invalidor në moshën 55 vjeçare për këta punonjës etj. Ndërsa përfaqësuesja e sindikatës së KEDS-it, Afërdita Kaçi u tha se problem kryesor është largimi nga vendi i punës për punëtorët me kontrata pune, mosnënshkrimi i kontratës së rregullt për punëtorët që nuk i kanë 10 vjet përvojë pune etj.

Përfaqësues tjerë të sindikatave dhe të shoqërisë civile shprehën shqetësimet lidhur me pushimin e lehonisë, ku u kërkua që pushimi të ndahet si leje prindërore e përbashkët për të dy prindërit. Gjithashtu u kërkua të gjinden modalitete nga qeveria që të mos zvogëlohet pushimi ose leja por përkundrazi të paguhet edhe 3 mujori i katërt, dhe barra e pagesës të kalojë nga shteti për të ndihmuar sektorin privat, si dhe njëkohësisht të ruajë vendin e punës për lehonat.

Lansimi i platformës dhe Mirënjohja për Barazi Gjinore

Në lansimin e platformës së www.pengenderhub.org si pjesë e iniciativës “Pro Wo+Man Gender Resource Hub” e cila financohet nga Olof Palme International Centre dhe implementohet nga OJQ PEN, nga BSPK morën pjesë Shukrije Rexhepi dhe Dafina Mehaj. Gjatë eventit u diskutua rëndësia dhe ndikimi i teknologjisë dhe internetit për të adresuar çështjet sociale, me fokus të veçantë- luftimi i stereotipeve dhe pabarazive gjinore. Panelistë ishin: Nita Luci, ligjëruese në Fakultetin e Filozofisë të UP-së dhe Hajrulla Çeku, nga organizata jo-qeveritare "EC Ma Ndryshe". Në fund u bë ndarja e mirënjohjeve për barazi gjinore për sindikatat më të përkushtuara në integrimin gjinor. Nga BSPK mirënjohja iu dha kryetares së rrejtit të gruas zj. Shukrije Rexhepit, për bashkëpunim të mirëfillt dhe kontribut të vazhdueshëm mbi integrimin e perspektivës gjinore në strukturat sindikale.

Me datën 23 dhjetor si vazhdimësi e aktiviteteve të rrejtit të gruas së BSPK, PEN dhe Qendërs për Politika dhe Avokim – QPA, do të mbahet një tryezë ku do të diskutohet plani ekzistues i veprimt të Rrejtit të Grave të BSPK, do të bëhet edhe plotësimi dhe ndryshimi i këtij plani sipas propozimeve të anëtarëve të Rrejtit të Grave si dhe do të krijohet kalendari dhe ndarja e përgjegjësive për vitin 2017.